



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:216025

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762686

C.nr. 526/2023

Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R. D. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lulzim Canaj, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit 80.00 euro, jashtë seancës, më datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses R. D. nga, dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditor, për 40 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej **80.00 euro**, dhe atë për periudhën prej datës 03.10.2022 e deri më datë 22.11.2022, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 98.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 06.10.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit prej 370.00 euro. Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune të paditura SHFMU "Dëshmorët e Kombit", në Kamenicë, në pozitën e edukatores. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 dhe KKAK-së të dt.22.01.2021, në nenin 35 parag.7.

Përfaqësuesi i paditëses, përmes parashtresës për precizimin e padisë, të dt.27.05.2023, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet e paditura që ne emr të shujtës ditore për 40 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 80.00 euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë në afat prej 7 ditësh, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditëses.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që kontratën të cilën e bazon paditësi nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Kamenicës, si e paditur, meqë e njëjta nuk është e regjistruar në MPMS-ës, si dhe është paraparë së bashkërisht MASHT-I dhe SBASHKU dhe Ministria e Financave angazhohen bashkërisht që të bëjnë sigurimin e mjeteve. Për më tepër ka theksuar se e paditura nuk ka marrë obligim përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata e lartëcekur e nga këto nuk ka legjitimitet real pasiv.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditëses është e bazuar.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “*kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë, në pozitën e edukatores.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, dhe KKAK-së të dt.22.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 7 të kësaj Kontrate, ku theksohet se “*Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve apo kuzhinave, andaj e obligoj të paditurën që paditëses t'ia kompensoj për 40 ditë pune, shumën prej 80.00 euro, në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, nga data 03.10.2020, e deri më datën 22.11.2022. Gjykata

sa i përketë ditëve të pranisë në punë është bazuar në vërtetimin nr.318, i dt.30.11.2023, i leshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë, në emër të paditëses.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t’i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, nuk është e regjistruar, si dhe faktin se të njëjtit nuk janë palë nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit dhe për të njëjtit si Drejtori Komunale e Arsimit, nuk paraqet ndonjë detyrim, duke konsideruar se nuk kanë legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore dhe e njëjta të refuzohet si e tillë, për faktin se paditësja nuk ka arritur ta vërtetojë kërkesëpadinë e tij, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 2, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, poashtu duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4, pika 2, të kësaj kontrate Kolektive të lartëcekur, paditësi, me pozitë të punës mësimdhënës lëndor, hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive e Arsimit. Andaj, përgjegjësia për kompensim shujtës ditore është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8 % ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 78.00 euro dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 20.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 98.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan – Dega në Kamenicë
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.526/2023, më datë 31.05.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli, d.v

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.